



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



05 /Nr. 9192/2022
Data: 31.10.2022

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 20.10.2022 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit në ora 15:00 dhe prezent ishin 19 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtori për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport z.Hisni Luri.

Rendi i Punës

1. Draft rregullore për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Elezit.

Hisni Luri është procedurë ligjore që të mbahet debati publikë në mënyrë që edhe jepni propozime në mënyrë që kjo rregullore të bëhet sa më e kompletuar. Draft rregullorja është shqyrtuar në komitet për politik e financa, në kuvendin e komunës dhe pas debatit publik do të përcillet për miratim në kuvendin e komunës. Sa i përket debatit njoftimi është bërë me kohë në vebfaqe të komunës dhe keni pasur mundësi që ta lexoni sepse dokumenti ka qenë i publikuar. Propozime mund të parashtroni por deri në mbledhje të kuvendit që do të mbahet me datë 27.10.2022 që mendoni që ndonjë propozim duhet të jetë në këtë draft rregullore mund ta propozoni.

Propozimi i znj.Sevime Bajrami:- propozoj që tarifa për klasën I deri në klasën e IX të jetë 2.00 € , ndërsa për të rritur të jetë 5.00 €.

Propozimi i z.Faruk Berisha:- propozoj që tarifa për klasën I deri në klasën e V të jetë 1.00 €, ndërsa për klasën VI deri në klasën e IX të jetë 2.50 €.

Propozimi i z.Akif Shkreta:- propozoj që tarifa për klasën I deri në klasën e IX të jetë pa pagesë , ndërsa për të rritur pagesa të jetë 15 €.

Propozimi i z Orhan Bushi:- propozoj që tarifa për të rritur të jetë 10 €.


Propozimi i z.Ahmet Krasniqi:- propozoj që tarifa për studentë të jetë gjysmë çmimi.

Propozimi i z.Sulejman Lusnjani:- propozoj që tarifa për nxënës të jetë pa pagesë , ndërsa për të rritur pagesa të jetë 10 €.

Hisni Luri a keni edhe ndonjë propozim për draft rregulloren për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit, nëse nuk keni, propozimet e parashtruara do t'i përcjellim për në kuvend për shqyrtim dhe ata të cilët i vlerëson kuvendi që janë të arsyeshme besoj se do të miratohen. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 15:30.

Procesmbajtësja
Vjosa Rogaqi



Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Hisni Luri

